




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



RROKUM TV
Migjen KELMENDI
Drejtor
Prishtinë

Ankesa Nr. 2017/56 KPM vs RROKUM TV
Ref:1708/777/KPM/am

VENDIM

**Lidhur me Ankesën nr. 2017/56 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) kundër
RROKUM TV (“Pala Përgjegjëse”)**

Faktet

1. Pala Përgjegjëse, është pajisur me Licencë të KPM-së me datën 5 dhjetor 2008. Pranimi dhe nënshkrimi i Licencës obligon të Licencuarin që të veprojë në përputhje me Ligjin e KPM-së dhe me të gjitha aktet nënligjore të miratuara nga KPM.
2. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), ka miratuar Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM-2016/03, i cili ka hyrë në fuqi më 11 tetor 2016. Me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 janë përcaktuar rregullat e etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në pajtim me dispozitat ligjore që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike.
3. KPM, gjatë kohës së fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme, ka bërë monitorimin e Palës Përgjegjëse me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë me Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM-2016/03, me theks të veçantë prezencën e fëmijëve në spotet e ndryshme promovuese të partive politike.
4. KPM, bazuar në monitorimet që janë bërë gjatë fushatës zgjedhore për pajtueshmërinë e Palës Përgjegjëse me Ligjin për Zgjedhjet Nr. 03/L-073, ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka transmetuar spot politik në të cilin ishin të përfshirë fëmijë. Spoti është identifikuar si spot me pagesë nga subjekti politik AAK.

Analiza Ligjore

5. Komisioni, bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se, Pala Përgjegjëse gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës ka transmetuar spot politik në të cilin ishin të përfshirë fëmijët dhe me këtë ka bërë shkelje të nenit 9, paragrafi 7, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03, i cili përcakton se:

“Nuk lejohet përdorimi dhe prezenca e fëmijëve në spotet e ndryshme promovuese të partive politike.”

Vendimi

6. Komisioni, bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje shkelje të nenit 9, paragrafi 7, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
7. Komisioni, bazuar në nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, sanksionon me **Vërejtje** Palën Përgjegjëse për shkelje të nenit 9, paragrafi 7, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

E drejta për Ankesë

8. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
9. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysht vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.

Adnan MEROVCI
Kryetar



10.08.2017
Datë